



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 706 Prot.

Tiranë, 22.6 2017

URDHËR Nr. 121, Datë 22.6 2017 PËR


VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË PUNË TË PUNONJËSVE TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR 6-MUJORIN E PARË 2017

Në zbatim të nenit 37 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 62 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, si dhe të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” e ndryshuar me VKM Nr.252, datë 30.03.2016, Rregulloren e Brendshme të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr 85, datë 30.06.2015 dhe 85/1, datë 30.06.2015 të Kryetarit të KLSH,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm/Drejtori i Përgjithshëm si dhe Drejtorët e Departamenteve / Drejtorive, të marrin masat e nevojshme që në zbatim të detyrimeve të tyre funksionale për vlerësimin e rezultateve në punë të punonjësve të KLSH-së për 6-mujorin e parë, të përcaktuara këto në VKM-në nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” e ndryshuar me VKM Nr. 252, datë 30.03.2016, të përfundojnë brenda afatit, procedurat e dhënies së këtyre vlerësimeve si dhe shqyrtimit të ankesave në lidhje me to.
2. Drejtorët e Departamenteve/Drejtorive gjatë 15-ditëshit të dytë të muajit qershor duhet të takohen me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të përcaktuar objektivat kryesorë të punës që bëjnë të mundur realizimin e planit të veprimtarisë audituese si dhe përmbushjen e objektivave të institucionit.
3. Vlerësimi i rezultateve në punë për 6-mujorin e parë të vitit 2017, do të përfundojë brenda datës 15 Korrik 2017 sipas afateve të përcaktuara në VKM-në Nr. 252, datë 30.03.2016 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.

4. Vlerësimi i rezultateve në punë për 6-mujorin e parë të vitit 2017, do të bëhet sipas formularit përkatës të përcaktuar në lidhjen nr. 2 të VKM-së nr. 252, datë 30.03.2016 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” .
5. Në procesin e vlerësimit do të merren në shqyrtim vendimet përkatëse të evadimit të auditimeve, në veçanti ato që janë vlerësuar dobët nga Kryetari i KLSH-së, dosjet e auditimit të riaudituar nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës, shqyrtimet e kryera nga Komisioni i Etikës, si dhe vlerësimet e dosjeve të auditimit të bëra në zbatim të Urdhrit nr. 4, datë 13.01.2015 “Për kriteret e vlerësimit të veprimtarisë audituese të stafit auditues” të Kryetarit të KLSH-së.
6. Në procesin e vlerësimit të mbahet parasysh edhe aktivizimi dhe rezultatet në trajnime apo shkrimet në media, konferencat shkencore etj.
7. Nëpunësit të cilët nuk do të jenë dakord me vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, kanë të drejtë të kërkojnë shqyrtimin e këtij vlerësimi sipas përcaktimeve të bëra në Kreun V, të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014, e ndryshuar.
8. Linja e Zyrtarëve raportues/kundërfirmues/autorizues, për vlerësimin përfundimtar të rezultateve nëpunës do të jetë Drejtor Departamenti/Drejtor Drejtorie/Sekretar i Përgjithshëm-Drejtor i Përgjithshëm/Kryetar i KLSH-së.
9. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm/ Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve/ Drejtorive si dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij urdhri.
10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Bujar LESKAJ

